

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i përgjithshëm , Divizioni Civil, sipas gjyqtarit, Halil Zahiri me s. juridike Shefinaze Sahiti, në çështjen juridiko-civile të paditësit, J.B., nga f. K., Komuna e Gj., i përfaqësuar prej av.Y. H., nga Gj., kundër të paditures, N. G., nga Gj., rr. ..., nr. ..., për pagesën e borgjit, jasht seancës gjyqësore më dt.12.05.2017, bie këtë

A K T G J Y K I M
Në bazë të heqjes dorë nga kërkespadia

I. REFUZOHET kërkerspadia e J.B., ndaj të paditures, N. G., nga Gj., për pagesën e borgjit, për shkak se paditësi me parashtresën e ushtruar më dt.10.05.2017, ka konfirmuar se e ka tërheq padinë dhe ka heq dorë nga të gjitha pikat e kërkesëpadisë, për shkak se palët ndërgjyqëse çështjen kontestuese e kishin zgjidhur në rrugën jashtgjyqësore.

II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, lënda C.nr.36/2016, konsiderohet e kryer dhe arkivohet nga Gjykata Themelore, në Gjilan.

III. Në bazë të nenit 450 të LPK-ës, gjykata vendosi, sejcila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi, J.B., nga f. K., Komuna e Gj., me padi-kërkespadi, të ushtruar kësaj gjykate kishte kërkuar të detyrohet e paditura, N. G., nga Gj., t ia paguajnë paditësit borgjin në lartësi prej 15.000,00 €, me kamatën ligjore.

Me parashtresën e ushtruar nga paditësi, më dt.10.05.2017, kësaj gjykate, jasht seancës gjyqësore kishte konfirmuar se në këtë fazë të procedurës e tërheqi padinë dhe heqi dorë nga gjitha pikat e kërkesëpadisë, për shkak se palët ndërgjyqëse çështjen kontestuese e kishin zgjidhur në rrugën jashtgjyqësore.

Gjyqëtari i çështjes pasi kishte e marrë konfirmimin e palës paditëse, për shkak të ekonomizimit të procedurës, në tërësi e ka aprovuar tërheqjen e padisë dhe heqjen dorë nga kërkespadia, për këtë vendosi si në pikën I dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, lënda C.nr.36/2016, konsiderohet e kryer dhe arkivohet nga Gjykata Themelore, në Gjilan.

Nga të cekurat më lart, në bazë të nenit 143, 149 dhe 388 të LPK-ës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në bazë të nenit 450 të LPK-ës, gjykata vendosi, secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Gjyqtari
Halil Zahiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimi të të njejtit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftuara përmes kësaj Gjykate.